

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
NOTER ARBEN NDINO BERAT
Nr. 1253 - 309



KONTRATE SHITJE

Sot, me date 04.09.2005, para meje Noterit publik Arben Petro Ndino u paraqiten personalisht ne zyren e Noterise ne qytetin e Beratit,

S H I T E S I: z. Eduart Kasemi i biri i Isufit dhe i Fatimese dtl. 29.04.1975, lindur dhe basnues ne Berat. Lagjen Kala.

B L E R E S I: z. Kasem Mahmutaj, i biri i Bajramit dhe i Sanies dtl. 16.04.1962, lindur dhe banues ne Berat. Lagjen Deshmoret e Kombit.

Palet me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar me vullnetin e tyre te lire dhe te pa vesuar pohojne para meje Noterit publik lidhjen e kesaj kontrate shitje te pasurise se luajteshme, ne baze te nenit 705, 750 e vijues te Kodit civil, si me poshte vijon:

Shitesi eshte ortak ne shoqërine anonime "Onufri TV" sh.A. me objekt prodhimin dhe trasmetimin e programeve te ndryshme televizive. Kjo shoqëri eshte njohur dhe rregjistruar ne rregjistrin tregetar me vendimin gjyqësor te Gjykates se Rrethit Tirane nr.20425, date 15.12.1998. Ne kete shoqëri ortaku Eduart Kasemi zoteron 10% te shumes se pergjithshme te kapitalit te shoqërise.

Per te gjithë kete pjese te kapitalit te shoqërise shitesi, me vullnetin e tij te lire pohon se ia shet bleresit kundrejte nje cmimi prej: 1'000'000 nje milion leke per te cilat shitesi pohon se i ka marre deri ne lekun e fundit nga bleresi.

Shitesi e garanton bleresin se te gjithë kete prone e ka te lire nga çdo detyrim financiar dhe se kjo prone eshte e lire nga cdo barre dhe hipoteke. Bleresi pohon se ka mare ne zoterim te plote kete pjese te kapitalit si me siper dhe se ka paguar tek shitesi rregullisht cmimin si me siper pa verejtje, duke pranuar njekohesish edhe blerjen e kesaj pjese te kapitalit te shoqërise rregullisht pa verejtje.

Që nga ky moment, që palet kane kryer reliasht kete veprim juridik, shitesi nuk ka me asnje te drejte mbi te gjithë kete prone dhe bleresi behet pronar me te drejta te plota dhe pa kushte mbi te gjithë kete pjese te kapitalit te kesaj shoqërie te sipershenuar.

Paleve iu sqarua pozicioni ligjor i deklarimit te plote te çmimit te shitjes dhe i rregjistrimit te kesaj kontrate ne rregjistrin tregetar prane Gjykates Tirane. Kjo kontrate u shkrua nga une Noteri publik ne kater kopje te barabarta, te barazvlereshme dhe u lexua nga palet. Pasi u pa se ishte ne perputhje te plote me vullnetin e tyre te lire, u nenshkrua regullisht prej tyre ketu me poshte pa verejtje.

SHITËSI

Eduart Kasemi
H

BLERËSI

Kasem Mahmutaj

NOTERI

Arben Ndino